

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA	
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS-KOSOVSKA KATASTRARSKA AGENCIJA	
Nr./Gr.	01/2835/18
Nr./Tq./Br.str.	
Data/Datumi:	18-12-2018
PRISHTINË-PRISTINA	

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

OJQ FREE LIBRE OPEN SOURCE SOFTWARE KOSOVA (FLOSSK)

dhe

AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS (AKK)

Free Libre Open Source Software Kosova (FLOSSK), organizatë jo-qeveritare me nr. regjistrimi 5112343-3 e përfaqësuar nga Kryetar i Bordit Ekzekutiv z. Arianit Dobrosi, adresa: Rr. "Ganimete Tërbeshi", nr. 2, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

dhe

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), i përfaqësuar nga U.D. Kryeshf Ekzekutiv z. Avni Ahmeti, adresa: Rr. "Çlirimi" nr. 25, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

lidhin këtë *memorandum bashkëpunimi* bazuar në objektivin e përbashkët sipas dispozitave në vijim:

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

- Informacioni i hapur gjeografik është bazë për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës duke stimuluar ndërtimin e shërbimeve të mbivendosura në këtë insitution si nga institucionet publike, organizat jo-përfituese dhe bizneset.
- Palët synojnë të bashkëpunojnë me qëllim të vendosjs së informacionit gjeografik publik që disponon AAK në dispozicion të publikut të gjerë.
- Për të definuar të dhënat që do të vihet në dispozicon dhe dhënien e të drejtave, AKK-ja do të bëjë një zotim të ndarë ligjor të përpiluar bashkërisht nga palët.

Licenca e përdour në këtë zotim do të jetë Open Data Commons Open Database License (OdbL) siç definohet në këtë adresë <https://opendatacommons.org/licenses/odbl>. Në rast të përdorimit të të dhënave, AKK-ja do të atribuohet si burim i tyre.

Neni 3
Zotimet e FLOSSK-ut

1. FLOSSK do ta mbështesë AKK-në në komunikim me komunitetin e OpenStreetMap.
2. FLOSSK do të pranoj të dhënat që AKK i vënë në dispozicion për përdorim të komunitetit të hartografuesve të OpenStreetMap në pajtueshmëri me kërkesat teknike të AKK-së dhe kapacitetin që FLOSSK ka në dispozicion.
3. FLOSSK pajtohet se nuk do të ketë ndonjë përfitim financiar nga ky bashkëpunim përveç asaj që i ofrohet secilit qytetar përdorues të të dhënave të OpenStreetMap.

Neni 4
Zotimet e AKK-së

1. AKK-ja do të hapë të dhënat saj përmes konceptit "open data" për të ndihmuar ndërtimin e hartave të hapura që mbulojnë Kosovën në hartën e hapur OpenStreetMap, sipas Legjislacionit dhe rregulloreve në fuqi brenda AKK-së.
2. AKK-ja do të ofrojë informata të mjaftueshme për FLOSSK-un për të përdorur këto të dhëna.
3. AKK-ja do të përcaktojë një person kontaktues që do të mbikëqyrë fushat e bashkëpunimit.
4. AKK-ja do të ofrojë përkrahje nga aspekti teknik për aq sa ka mundësi brenda institucionit.

Neni 5
Kohëzgjatja e memorandumit të bashkëpunimit

Memorandumi mund të përfundohet nga secila palë përmes njoftimit me shkrim 30 ditë më herët.

Neni 6
Pëlqimi i palëve

1. Palët duhet të veprojnë në besueshmëri të plotë, të ndërsjellë, për të siguruar arritjen e të gjitha objektivave të marrëveshjes.
2. I gjithë informacioni i shkëmbyer që nuk ka për qëllim publikimin e jashtëm do të trajtohet si konfidencial nga palët dhe nuk do të ndahet me të tjerët përveç nëse ndryshe kërkohet nga ligjet në fuqi.
3. Çdo ndryshim i këtij memorandumi mund të bëhet vetëm me pajtim paraprak të të dyja palëve.

Neni 7
Nënshkrimi dhe obligimet

Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në dy (2) kopje origjinale, një prej të cilave arkivohet në Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe një në FLOSSK.

Neni 8

Ky memorandum nënshkruhet më datë 18.12.2018 në Prishtinë, dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


z. Avni Ahmeti
Kryesher Ekzekutiv
AKK






z. Arianit Dobrosi
Drejtore i Bordit Ekzekutiv
FLOSSK